



## **Kisha Anglikane e Shën Albanit, Kopenhagë**

Kisha e Shën Albanit, është kisha e vetme anglikane (episkopale) në Danimarkë, themeluar më 1887. Deri në atë kohë, krishterët anglezë-folës duheshin të merrnin objekte me qera në Kopenhagë dhe ne Elsinore (Helsingør). Kisha e Shën Albanit është pjesë e bashkësisë Anglikane e cila është e udhëhequr nga kryepeshkopi i Canterbury dhe është nën dioqezën e Evropës. Liturgjia në këtë kishë është ajo e Kishës së Anglisë.

### **Ndërtimi i Kishës**

Pas afro 30 vitesh vendosmërie, shumë punë dhe mbledhjen e fondeve, kisha u ndërtua në mes të viteve 1885-1887. Parcella e kishës afër Kështjellës Mbretërore, ishte siguruar me ndihmë nga Princesha Alexandra (1844-1925), e bija e Mbretit Christian IX të Danimarkës (1818-1906), dhe bashkëshortit të saj Princit të Wales (më vonë Mbreti Edward VII të Britanisë). Princi Edward ishte shumë i interesuar në këtë projekt dhe ishte kryesues i komitetit për mbledhjen e fondeve në Londër.

Princesha vuri gurthemelin më 19 Shtatorë 1885, e shoqëruar nga Princi, Mbreti Christian IX dhe Mbretëresha Louise, Mbreti dhe Mbretëresha e Rusisë (motra e Aleksandrës), si dhe anëtarë të familjeve mbretërore të Greqisë dhe Skandinavisë, të cilët u kthyen pas dy vitesh për të qenë dëshmitarë me rastin e themelimit të kishës më 17 Shtatorë të 1887.

### **Pamja e Jashtme e Kishës**

Kisha është shembull i mire i stilit Viktorian “Anglez i Hershëm,” të arkitekturës Gotike. Ishte dizajnuar nga arkitekti i kishës Viktoriane, Sir. Arthur Blomfield, dhe ishte ekzekutuar nën mbikqyrjen e arkitektit danezë, Prof. L. Fenger. Edhe pse në pamje është tipike angleze, të gjitha materialet janë daneze. Mvëshja e mureve është nga guri gëlqeror nga krahina Faxe dhe gurë stralli nga krahina Stevns, të dyja këto nga pjesa jugore e Sealand. Maja është ndërtuar prej gurëve të copëtuar nga Öland i Suedisë. Kulmi është i mbuluar me tjegulla nga Broseley, Shropshire. Për shkak të natyrës së tokës, kisha është ndërtuar mbi maja, ndërsa dyshemeja e dhomës së nëndheshme është në nivelin e ujit e cila është mbajtur e thatë me ndihmën e pompës automatike.

### **Pamja e Brendshme e Kishës**

Përveq pllakave përkujtimore dhe zbukurimeve në dritare, kisha ka ndërruar shumë pak që nga 1887, përveq instalimit elektrik dhe nxemjes qëndërore, të cilat janë vendosur në vitet e herëshme të 1930-ave. Enterieri i mureve të brendshme është gëlqere e bardhë nga Faxe. Pllakat e dyshemesë janë donacion i kompanis Campbell Tile nga Staffordshire. Shkrimet (të vendosura tek dera për të mirëpritur vizitorët), katedra kishës dhe altari janë nga terrakota dhe ishin dhuratë nga Doultan & Co nga Londra.

Organi ishte ndërtuar nga J.W. Walker dhe Son of London më 1887 dhe gjindet ende në kutinë originale. Në 2004/5 ishte restauruar në Durham nga Harrison & Harrison dhe gama ju është zgjeruar për të përfshirë 1480 gypa. Zilet në kullë janë seti original prej 8 Harrington këmbanave të instaluar në 1887 (kulla nuk ishte ndërtuar për zile të mëdha). Në 2013 janë shtuar shtatë zile, po ashtu ndërtuara nga Harringtons të kohës së ngjashme. Zileve ju bihet para dhe pas serviseve; po ashtu ju bihet qdo çerek ore dhe për qdo orë himne të ndryshme.

Xhamat e dritareve të zbkuruara janë nga tri periudha të ndryshme. Xhamat në pjesën kryesore të kishës janë Viktorian të krijuar nga Heaton, Butler dhe Bayne në Londër nga 1887 deri me 1901. Dritaret anësore ishin krijuar si pjesë e përkujtimorës së Aleksandrit nga Geoffry Webb në pjesën e fundit të 1920-ave, dhe dritaret e faltorës si pjesë e përkujtimorës së Princeshës Viggo, të ndërtuar nga një kompani lokale më 1971. Dritaret Viktoriane ishin pastruar dhe ri-plumbosur gjatë një projekti në 2011/12.

## Shën Albani

Kisha është emëruar për hirë të Shën Albanit, martirit të parë të Anglisë (rreth vitit 303). Albani ishte një ushtarë Romak i cili mbrojti një prift nga persekutimi. Albani ishte i inspiruar shumë nga ligjeratat e priftit, sa që kishte veshur rrobat e priftit dhe kishte dorëzuar vetëveten kur ushtarët erdhën ta kërkonin priftin. Atë e kishin dënuar me vdekje mirëpo ai deklaroi se “Unë adhuroj dhe e dua Zotin e vërtetë, i cili ka krijuar çdo gjë.” Prifti i inspiruar nga besimi dhe guximi i Albanit po ashtu dorëzua. Sipas legjendës, gërmadhat e Albanit janë dërguar në kishën e Shën Mary dhe të Shen Albanit në Odense, Danimark, ku emri i Shën Albanit ende është i mbajtur në nderim.

Informata tjera rreth historisë së kishës mund të gjinden në fletushkuen e Historikut të Shën Albanit dhe udhërrëfyesin, të gatshëm në hyrjen e kishës.

## Sot

Ne jemi një familje krishtere internacionale, inklusive, e cila edhe pse adhuron Zotin sipas traditave Anglikane-Episkopale, mirëpret njerëz të të gjitha traditave krishtere, si dhe të gjithë ata të cilët janë në kërkim të besimit në Zot. Momentalisht ne kemi anëtarë nga 22 vende të ndryshme në kongregacionin tonë, dhe n'a bashkangjiten shumë vizitorë në ceremonit tona gjat verës. Gjithashtu gjendet edhe një kongregacion në Aarhus, i cili mbledhet tetë herë në vit në Møllevangs Kirke.

Nëse ju keni kohë, keni mundësinë që të ndezni një qiri dhe të recitoni ndonjë lutje para se të largoheni apo mund të lini një kërkesë në librin afër faltorës së kishës.

***Pasi që kisha nuk merr mbështetje financiare nga Britania e Madhe apo Danimarka, çdo kontribut do të vlerësohet shumë. Donacionet mund t'i leni në pjatë në tavolinë ose në kutinë të varurë në murë.***

**Faleminderit për vizitën tuaj në Kishën e Shën Albanit.  
Ju dëshirojmë çdo bekim dhe shpresojmë të ju takojmë përsëri.**